

## VENDIM I ASAMBLESE SË ORTAKËVETË SHOQËRISË

“PAMBUK” SH.P.K

Nr. 2 datë 11/11/2024

Sot më datë 11/11/2024, mbledhet Asambleja e Ortakëve të shoqërisë “PAMBUK” sh.p.k një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Shqipëri, me seli në Tiranë në adresën: Rruga Labinoti, Pallati 2, Shkalla 6, Kati 1, Apartamenti 42, Shqipëri; me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashem (NIPT) M42214047T.

Asambleja përbëhet nga ortakët e shoqërisë:

1. Znj. Sara Myrtaj, me numër ID J75608090J i datëlindjes 08/06/1997 lindur në Fier dhe banues ne Tiranë, Shqipëri, zotëruese e 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;
2. Z. Aleksandër Nikolli, me numër ID J60422032N i datelindjes 22/04/1996 lindur në Rrëshen, Mirditë dhe banues ne Tiranë, Shqipëri, zotërues i 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Mbledhja mbahet në Tiranë, në selinë e shoqërisë, në prani të ortakëve të sipërpërmendur dhe axhenda e takimit është:

1. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë PAMBUK sh.p.k nëpërmjet kontributeve në para nga ortaku Sara Myrtaj.

**Ortakët e Shoqërisë:**

### VENDOSËN:

1. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “PAMBUK” sh.p.k me Nipt M42214047T, në përputhje me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, referuar nenit 135, pika 2, gërma ë) në lidhje me zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit.

Zmadhimi i kapitalit do të realizohet nëpërmjet kontributeve në para të ortakut Sara Myrtaj në vlerën 200 Lekë.



Zmadhimi i kapitalit realizohet nëpërmjet zmadhimit të vlerës së kuotës së kapitalit, nga 5.000 (pesë mijë) Lekë, në 5.200 (pesë mijë e dyqind) Lekë.

Kapitali i shoqërisë PAMBUK sh.p.k nga 10.000 Lekë bëhet 10.200 Lekë, i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale dhe e ndarë sipas ortakëve, e paraqitur si më poshtë:

Kapitali i nënshkruar para zmadhimit			Shtesa		Kapitali i nënshkruar pas zmadhimit	
Ortakju	Vlera në Lekë	% e kuotave	Vlera në Euro	Vlera në Leke	Vlera në Leke	% e kuotave
Sara Myrtaj	5.000	50%	-	200	5.200	51%
Aleksander Nikolli	5.000	50%	-	-	5.000	49%
<b>Totali</b>	<b>10.000</b>	<b>100%</b>	<b>-</b>	<b>200</b>	<b>10.200</b>	<b>100%</b>

Përfundimisht:

Vlera e Kapitalit të shoqërisë ishte 10.000 (dhjetë mijë) Lekë dhe bëhet 10.200 (dhjetë mijë e dyqind) Lekë.


2. Vendimi për Zmadhimin e Kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
3. Kapitali quhet i zmadhuar, duke filluar nga çasti i regjistrimit të Vendimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i shoqërisë Z. Aleksandër Nikolli.

Asnjë vendim tjetër nuk u mor në këtë Mbledhje të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë PAMBUK sh.p.k.



NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, ortakët e shoqërisë PAMBUK sh.p.k, me vullnetin e tyre të plotë, firmosën këtë dokument.

**Sara Myrtaj**

Sara Myrtaj 

**Aleksandër Nikolli**

Aleksandër Nikolli  
